



**RAPORT
VJETOR**

2021

Emri i Shoqërisë:	Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group
Aktiviteti:	Operon në biznesin e sigurimit të jo – jetës në Republikën e Shqipërisë dhe nëpërmjet degës së saj në Kosovë edhe në Republikën e Kosovës.
Data e Themelimit:	Shkurt 1999
Bordi Mbikqyrës:	Z. Peter Hoefinger Kryetar Z. Christoph Rath Zv. Kryetar Z. Jonard Prodani Anëtar Znj. Liane Hirner Anëtar Znj. Sonja Raus Anëtar
Drejtor i Përgjithshëm:	Klaidi Çitozi
Bordi Drejtues:	Klaidi Çitozi Ervin Rali Artan Pjetërnikaj
Aksioner Kryesor:	Shoqëria mëmë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri, e cila zotëron 89.05% të aksioneve.
Numri i punonjësve:	317

SIGMA INTERALBANIAN VIG

është një Kompani Sigurimi Jo – jete e cila operon në tregun shqiptar që prej vitit 1999. Është pjesë e Vienna Insurance Group dhe është kompania e tretë në treg për nga vëllimi i primeve, me 13% të totalit të tregut. Sigma është kompania e parë private e sigurimeve në Shqipëri. Që prej krijimit të saj, ka kaluar në shumë sfida në këtë treg ende të paformuar mirë. Aktualisht, ajo është një Kompani e standarteve evropiane, e cila ofron produkte për të gjitha bizneset dhe individët, duke mbrojtur kështu gjithçka që ka vlerë për Klientin, shëndetin, pronën, biznesin!

TREGU I SIGURIMEVE 2021

Gjate vitit 2021 tregu i sigurimeve filloi të ketë një rimëkëmbje pas pandemisë dhe ka pasur një rritje të konsiderueshme. Rritja që shënoi tregu ishte 16.02% krahasuar me vitin 2020. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 2,659,788 mijë lekë duke arritur shifrën 19,267,798 mijë lekë.

Numri i kontratave arriti në 1,173,520 duke shënuar një rritje me 22.7 % krahasuar me vitin 2020.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 17,810,270 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 22.74 % krahasuar me vitin 2020.

Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 1,067,850 duke shënuar një ulje në masën 23.2% krahasuar me vitin 2019.

Gjatë vitit 2021, janë paguar gjithsej 6,665,582 mijë lekë dëme ose 11.08% më pak se gjatë vitit 2020.

Numri i dëmeve të paguara në vitin 2021 është rritur me 4,599 dhe arriti shifrën 52,780 nga të cilat 50,541 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 2,239 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

Shkurt 1999

U themelua kompania e parë private në Shqipëri,
SIGMA - Siguri e Madhe.

Tetor 2002

Sigma hyn në tregun maqedonas dhe liçensohet
nga autoritetet vendase.
Filloi aktivitetin e saj në 2003.

Shtator 2004

Sigma liçensohet që të operojë në
Kosovë dhe menjëherë pozicionohet
si kompani lider në treg.

Shtator 2007

Grupi më i madh i sigurimeve në Austri dhe CEE,
Vienna Insurance Group, investon
në tregun shqiptar të sigurimeve, duke bërë
pjesë të grupit të saj, kompaninë Sigma.

Tetor 2014

U bë bashkimi i kompanive Sigma dhe Interalba-
nian dhe tani operojnë në treg me emrin
Sigma Interalbani VIG.

Maj 2016

Z. Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lider historik i
kësaj kompanie për t'ia pasuar menaxhimin,
Z. Klaidi Çitozi.

HISTORIKU I SIGMA INTERALBANIAN VIG

Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP u themelua në 1999 dhe regjistrua në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Aktiviteti i saj rregullohet nga nenet e Ligjit Nr. 9901 me datë 14 prill 2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr. 52 datë 22 maj 2014 "Për aktivitetet e sigurimit dhe risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", dhe aktet nënligjore të dala në funksion të tij.

Aktiviteti i saj kryesor është ofrimi i sigurimit për mjetet motorike, pronën, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë.

Në 2004 gjithashtu fitoi aktivitetin e saj në Kosovë nëpërmjet degës së saj. Shumë shpejt pas krijimit të saj, Sigma vendosi të zgjeronte aktivitetin edhe në rajon, duke hapur degët e saj përkatësisht në Maqedoni dhe Kosovë.

Në këto tregje, falë përvojës dhe ekspertizës së stafit, arriti shumë shpejt të pozicionohet si kompani lider.

Në shtator të vitit 2007, Vienna Insurance Group vendosi të hyjë në tregun shqiptar, duke blerë aksione të kompanisë Sigma. Kjo kompani jo vetëm solli një frymë evropiane në tregun shqiptar, por ishte një emër që pëcillte gjithashtu stabilitet dhe siguri për klientët. Gjatë vitit 2014, Sigma dhe Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP sh.a. u bashkuan.

Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë u ndryshua nga "Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a në "Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.

Në Maj të vitit 2016, Z. Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lider historik i kësaj kompanie për t'ia pasuar menaxhimin e kompanisë, Z. Klaidi Çitozi.

Pavarësisht se i ri në moshë, z. Çitozi ka qënë pjesë e kompanisë prej më shumë se një dekade përpara se t'i besohet kjo përgjegjësi, të cilën e çon përpara me shumë përkushtim dhe sukses.

EKSPERTIZË DHE STABILITET

Vienna Insurance Group është një grup ndërkombëtar sigurimesh, me selinë qendrore në kryeqytetin Austriak. Pas rënies së Perdes së Hekurt në vitin 1989, VIG –filloi zgjerimin e tij, nga një biznes totalisht Austriak në një grup internacional. VIG është sinonim i stabilitetit dhe ekspertizës për të siguruar mbrojtje –financiare ndaj rreziqeve të ndryshme. Eksperienca, e kombinuar me një fokus në aftësinë tonë kryesore, atë për t’u siguruar ndaj rreziqeve, formojnë një bazë të sigurt dhe të fortë për mbi 22 milionë klientët që ka Grupi.

FOKUS NË EVROPËN QËNDRORE DHE LINDORE


Përveç se në Austri, VIG e konsideron si tregun e tij edhe Evropën Qëndrore dhe Lindore dhe ndjek një strategji afatgjatë në tregjet ku ka përfaqësi. Grupi gjeneron më shumë se gjysmën e të ardhurave nga primet në CEE dhe ende e shikon që ka potencial për rritje të konsiderueshme në këtë rajon. Rritja ekonomike në Evropën Qëndrore dhe Lindore, ishte mesatarisht dy herë më e madhe se në Europën Perëndimore dhe niveli i sigurimeve për frymë është ende më i ulët se mesatarja Evropiane.

PREZENCË NE TREGUN LOKAL

Për VIG, mbrojtja e klientëve –financiarisht nga rreziku është një përgjegjësi. Grupi ndjek një strategji multi brand të bazuar në tregjet lokale si dhe në menaxhimin lokal. Së fundmi, suksesi i grupit dhe afërsia me klientin është baza e çdo brandi individual dhe know – how lokal.

FINANCA TË FORTA & VLERËSIMI I KREDITIT

VIG ka një vlerësim A+ me një parashikim të qendrueshëm, nga agjensia e mirënjohur e vlerësimeve, Standard & Poor’s. Vienna Insurance Group është e listuar jo vetëm në bursën e Vienës por edhe në Pragë. Wiener Städtische Versicherungsverein – një aksioner kryesor i qëndrueshëm me një fokus afatgjatë – ka rreth 70% të aksioneve të VIG. Aksionet e tjera tregtohen në bursë.



PROFILI I

VIENNA INSURANCE GROUP



»» Ne fokusohemi që klientëve tanë në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore, t'u ofrojmë produkte të përshtatura posaçërisht për nevojat e tyre. Strategjia jonë drejtohet nga përfitueshmëria afatgjatë dhe rritja e qëndrueshme e fitimit, duke na bërë një partner të besueshëm në këto kohë që ndryshojnë kaq shpejt. ««

Mbi 25,000 punonjës punojnë për Vienna Insurance Group (VIG), në rreth 50 kompani në 30 vende të ndryshme. Ne zhvillojmë zgjidhje për sigurimet duke u përputhur me nevojat personale dhe lokale, e cila na bën lider në industrinë e sigurimeve në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore.

<p>ALBANIA</p> <p>SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>DENMARK</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>LIECHTENSTEIN</p> <p>VIENNA-LIFE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>ROMANIA</p> <p>OMNIASIG VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Asirom VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>DE VIATA BCR ASIGURARI VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>AUSTRIA</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Ionau VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>ESTONIA</p> <p>bta VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Seesam VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>LITHUANIA</p> <p>bta VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SERBIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>WIENER RE Beograd VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>BELARUS</p> <p>КУПАЛА VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>FRANCE</p> <p>VIG Re</p>	<p>MOLDOVA</p> <p>DONARIS VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SLOVAKIA</p> <p>Kooperativa VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>KOMUNÁLNA POISTOVŇA VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>BOSNIA-HERZEGOVINA</p> <p>WIENER OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>vienna osiguranje VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>GEORGIA</p> <p>GPI VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>IRAO VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>MONTENEGRO</p> <p>Život WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SLOVENIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>BULGARIA</p> <p>BULSTRAD VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life BULSTRAD VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>PENSION ASSURANCE COMPANY DOVERIE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>GERMANY</p> <p>InterRisk VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>VIG Re</p>	<p>NORTH MACEDONIA</p> <p>WINNER VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life WINNER VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>МАКЕДОНИЈА ОСИГУРУВАЊЕ MAKEDONIA OSIGURUVANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SWEDEN</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>CROATIA</p> <p>WIENER OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>HUNGARY</p> <p>UNION VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>NORWAY</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>TURKEY</p> <p>RAYSIGORTA VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>CZECH REPUBLIC</p> <p>Kooperativa VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ČPP VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>VIG Re</p>	<p>ITALY</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>POLAND</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>InterRisk VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Vienna Life VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>wiener VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>UKRAINE</p> <p>КНЯЖА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life КНЯЖА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>USG VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>LATVIA</p> <p>bta VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>KOSOVO</p> <p>SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<td> </td>	

Status: January 2022

WE ARE NUMBER 1
IN CENTRAL AND EASTERN EUROPE.

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP
Protecting what matters.

Grup
sigurimesh
Lider
në CEE

Rreth

50

kompani të grupit

VIG ka listuar aksionet që në

1994

në bursën e Vienës.

Vlerësimi më i mirë
në ATX:

A+

me parashikim
të qëndrueshëm

nga Standard & Poor's

Bashkëpunim me

ERSTE GROUP

Banka më e madhe e retail në CEE

Përfaqësi
në

30

VENDE

Mbi

25,000

punonjës

Iu shërbejmë më shumë se

22

MILION KLIENTËVE



Misioni, vizioni dhe premtimi ynë



MISIONI

Ne jemi sinonim i stabilitetit dhe kompetencës përsa i përket mbrojtjes nga rreziku. Ne përdorim eksperiencën, njohuritë dhe diversitetin tonë për të qënë më pranë klientëve tanë. E konsiderojmë përgjegjësinë tonë që të mbrojmë ato që kanë vlerë për klientët tanë.



VIZIONI

Ne duam të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Grupet e interesit na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Kjo bën të mundur që ne të forcojmë pozicionin tonë si grupi lider në sigurime në Austri, Europën Qendrore dhe Lindore.



PREMTIMI YNË

Ne bëjmë të mundur që klientët tanë të jetojnë një jetë më të sigurt dhe më të mirë sepse ne: Mbrojmë atë që ka vlerë për ju!

VLERAT TONA



Diversiteti



Marrdhënia me klientin



Përgjegjësia

No. 1

Austria
Vendet Balltike
Bullgaria
Republika Çeke
Gjeorgjia
Hungaria
Maqedonia e Veriut
Romania
Slovakia

Top 5

Shqipëria
Bosnia dhe
Hercegovina
Kroacia
Kosova
Moldavia
Polonia
Serbia
Ukrahinë



Kompania ka një traditë shumë të mirë në sigurimet e pasurisë gjithashtu. Ekspertiza e fituar ndër vite dhe e përforcuar nga trajnimet e vazhdueshme pranë kompanisë mëmë, bëjnë që të ofrojmë zgjidhje në sigurime jo vetëm për bizneset vendase por edhe për investitorët e huaj. Me 12% të tregut, kompania renditet e treta edhe në këtë portofol duke shënuar një rritje prej 23.87% krahasuar me vitin 2020.

Kompania vazhdon të ndjekë një politikë të kujdesshme përsa l përket sigurimit të Aksidenteve dhe Shëndetit. Politikat e marrjes në sigurim dhe procedurat e trajtimit të dëmeve zbatohen me përpikmëri, duke bërë që të kemi një portofol profitabël por dhe me një shërbim klienti të shkëlqyer. Duke qënë se gjatë vitit 2021, njerëzit ishin shumë të ndjeshëm ndaj shëndetit, ky portofol shënoi një rritjen më të madhe në treg për kompaninë tonë me mbi 20%, ndërkohë që rritja mesatare e tregut ishte 4%.

Sigma Interlbanian VIG ka një rënie të ndjeshme të vlerës së dëmeve pezull, një tregues që po punon me shumë përkushtim për trajtimin e kërkesave të klientëve në kohë dhe në përputhje me kushtet e sigurimit, ligjet dhe rregulloret në fuqi. Kompania ka 14 milion Euro dëme pezull, dhe pjesa më e madhe e kësaj vlere përbëhet nga dy dëme, të cilat janë për t'u vlerësuar në Gjykatë, dhe sipas gjykimit të kompanisë nuk janë subjekt mbulimi i Kushteve të Përgjithshme të kontratave përkatëse. Sigma Interlbanian ka paguar mbi 300.000 Euro për dëmet e trajtuara në Fondin e Kompensimit, ose 13% të totalit të këtyre dëmeve.

Ne jemi pararojë në sigurime, duke ofruar këshillim dhe produkte sigurimi për çdo biznes dhe individ, duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të tyre. Ekipi ynë teknik është i aftë të ofrojë sigurime që i përshtaten çdo kërkesë dhe rrethane në vendin tonë. Njohuritë dhe eksperiencia e stafit tonë, është një ndër pikat e forta të kompanisë.

Duke qënë se tregjet financiare janë gjithnjë në ndryshim, ne tregohemi të kujdesshëm që stafi ynë të trajnohet vazhdimisht që t'i përshtatemi sa më mirë dhe në kohë këtyre ndryshimeve. Në ekipin tonë kemi punonjës me njohuri teknike të shkëlqyera, por edhe ata me ekspertizën dhe njohuritë mbi ligjet dhe rregulloren në fuqi. Ky është një kombinim i shkëlqyer që na bën zgjedhjen e parë të klientëve që kërkojnë mbrojtje dhe siguri maksimale gjatë aktivitetit të tyre.

PROFILI I SIGMA INTERALBANIAN VIG

Viti 2021 ishte një vit tjetër mjaft i vështirë, por kishte edhe shumë gjëra për të cilat duhet të jemi mirënjohës. Vaksina për COVID – 19 filloi të shpërndahej, dhe që në fillim të vitit ishte i aksesueshëm për publikun edhe në Shqipëri. Fillimisht për profesionet që ishin më të ekspozuar ndaj riskut të infektimit dhe për të moshuarit e më pas për të gjithë.

Megjithëse vendi ynë nuk ishte në një paralizim total për shkak të COVID –19, vaksina u mirëprit me shumë interes në vendin tonë. Ishte një mesazh shprese që shumë shpejt gjërat do t'i kthehen normalitetit.

Dhe në fakt, në 2021 filloi dhe rimëkëmbja e ekonomisë nga ai vit i mbrapshtë nga i cili kishte vuajtur i gjithë globi. Të ardhurat nga sigurimet në nivel kombëtar shënuan një rritje prej 15.4%, duke kaluar kështu edhe të ardhurat nga primet që u realizuan në vitin 2019 me 9%.

Sigurisht që me fillimin e funksionimit të bizneseve dhe lëvizjes së lirë, rritjen më të madhe e shënuan sigurimi nga Aksidentet, me 42.53% si dhe sigurimet e mallit në transport me 46%. Duke qënë se Shqipëria ishte një vend me shumë pak kufizime për shkak të pandemisë, bëri që të ishte dhe destinacioni i preferuar i shumë turistëve, dhe kjo u vu re nga rritja e të ardhurave nga polica kufitare me 122.39%.

I njëjti trend u vu re gjithashtu edhe për kompaninë Sigma InterAlbanian VIG, i cili në fund të vitit 2021 u rendit kompania e tretë në treg duke konsideruar të ardhurat nga primet me 13% të tregut. Të ardhurat nga primet shënuan një rritje prej 11.63% krahasuar me vitin 2020. Vijnë të mbetet kompania e dytë për pagesat e dëmeve duke paguar kështu mbi 18% të totalit të dëmeve të jo – jetës, dhe kështu rreth 42% të të ardhurave nga primet shkojnë si pagesë për dëmshpërblimet që rrjedhin si detyrim nga kontratat e sigurimit.

Edhe gjatë këtij viti, struktura e primeve ka qënë e qëndrueshme dhe $\frac{1}{4}$ e primeve vjen nga sigurimet vullnetare. Vijnë të jenë pikë e fortë sigurimet motorike dhe është kompania e dytë në TPL e brendshme dhe kompania e tretë në sigurimet KASKO dhe Karton Jeshil.

2021

në shifra

Sigma InterAlbanian ka pasur një ecuri të qëndrueshme gjatë vitit 2021. Ju kemi shërbyer më shumë se 145.000 klientëve duke ju ofruar produktet tona, dhe kemi dëmshpërblyer mbi 6.400 klientë. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto gjatë këtij viti kanë arritur shifrën afërsisht 19 milionë Euro dhe zotëron rreth 13% të tregut. Rreth 25% e këtyre primeve vijnë nga sigurimet vullnetare.

145.000 klientë

PRIME

19 mln EURO

Dëme të paguara

9.3 mln EURO

Provigjionet Teknike

mbi 32,5 mln EURO

Treguesi i Likuiditetit

255%

Treguesi i Mjaftueshmërisë

135%

AKTIVET

mbi 50 mln EURO

KAPITALI

rreth 11 mln EURO

Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit:

Aftësia Paguese është 572.648 mijë lekë më shume se niveli i kerkuar.

Marzhi i aftësisë paguese = 254.8%

Norma e likuiditetit

gjatë gjithë vitit 2021 ka rezultuar më e madhe se **1 (një)** duke plotësuar kërkesat rregullative të AMF

Treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike

134.7 %




Nëpërmjet aplikimit të parimeve të marrjes në sigurim, administrimit të rreziqeve me kontrata risigurimi të klasit parë, ne kemi mundësi të marrim përsipër me garanci të plotë çdo lloj rreziku. Në çdo kontratë sigurimi jemi të mbuluar përveç se me kapacitetet tona, edhe me mbështetjen e VIG Re, e cila është e vlerësuar nga Standarts and Poors me A+. Mbështetja e padiskutueshme e aksionerit tonë kryesor, Vienna Insurance Group, na vë njëherësh edhe përpara përgjegjësisë që të synojmë t'i përmbahemi standarteve më të larta në ofrimin e shërbimeve.

Stafi i kompanisë, i cili ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, ofron asistencë teknike dhe shërbim klienti të shkëlqyer. Njohuritë e marra në trajnimet dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve si në Shqipëri ashtu edhe në grupin VIG, i aplikojnë në punën e përditshme, si në dizejmin e produkteve të sigurimit, ashtu edhe në mënyrën e qasjes ndaj klientit apo trajtimit të dëmeve.

Pjesë e Vienna Insurance Group

Ne jemi krenarë që jemi pjesë e grupit VIG, rrënjët e të cilit datojnë më shumë se 190 vite më parë në Austri. Aktualisht ky grup operon në 25 vende të Europës Lindore dhe Qendrore me më shumë se 50 kompani. Ka një prej vlerësimeve më të mira nga Standards and Poors, A+ dhe një perspektivë e qëndrueshme, ndër kompanië e përfshira në indeksin ATX të Vienna Stock Exchange.

Dega jonë në Kosovë, vazhdon të jetë një histori suksesi, që prej shumë vitesh tashmë, dhe është një nga kompanitë lidere ne treg bazuar ne volumen e primeve te realizuara per te gjitha linjat e bizneseve.



BORDI I DREJTORËVE

Kompania Sigma Interlbanian, menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve i cili ka në përbërje të tij, Drejtorin e Përgjithshëm dhe dy anëtarë.



Z. Klaidi Çitozi
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Z. Çitozi është pjesë e kompanisë prej shumë vitesh, tetë vjet nga të cilat si anëtar i bordit, dhe që prej vitit 2016 edhe si drejtues ekzekutiv i kësaj kompanie. Karrierën e tij e ka filluar në sektorin bankar, dhe më pas ka ofruar ekspertizën e tij në tregun e sigurimeve. Që në fillim ka punuar për kompaninë Sigma me shumë përkushtim. Ai është aktuar i certifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e marrjes në sigurim. Është një ekspert shumë i mirë në sigurime, ndaj dhe mbikqyr departamentet kryesore teknike në kompani siç janë ai i Menaxhimit të Riskut, Marrjes në Sigurim, Risigurimeve, Aktuaristikën, Marketingun dhe Financat.



Z. Ervin Rali
ANËTAR BORDI

Z. Rali ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, duke qënë dhe një ndër pionerët e kësaj industrie, veçanërisht në zhvillimet e teknologjisë që ka pasur tregu. Ka punuar në këtë industri që në fillimet e karrierës së tij, jo vetëm në Shqipëri por edhe në Kosovë për kompani të ndryshme sigurimi. Ai iu rikthye kompanisë Sigma Interlbanian në vitin 2016 si Anëtar i Bordit të Drejtuesve të kompanisë, duke pasur në fokusin e tij veçanërisht shitjet, zhvillimet teknologjike, digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve. Këto detyra iu besuan jo vetëm për shkak të formimit të tij, por edhe aftësive menaxhuese me stafin, klientët edhe partnerët.



Z. Artan Pjetërnikaj
ANËTAR BORDI

Z. Pjetërnikaj iu bashkua Sigma Interlbanian si Anëtar i Bordit Menaxhues në fillim të vitit 2021. Përpara kësaj periudhe, ai ishte i angazhuar në funksione të larta si drejtues në Policinë e Shtetit dhe në sektorin privat bankar. Megjithëse një eksperiencë e re për të, ai u përfshi menjëherë në zbatimin e detyrave të tij, dhe me eksperiencën e tij ndihmoi në përmirësimin e shumë proceseve në kompani. Në kompani është i angazhuar kryesisht me çështjet ligjore, mbikqyrjen e trajtimit të dëmeve, administrimit dhe burimet njerëzore.

Parimi i vlerësimit dhe menaxhimit të riskut

Procesi i vetevlerësimit të risqeve dhe aftësisë paguese është një proces i brendshëm që shoqëria do të kryejë çdo vit për të vlerësuar pershtatshmerinë e menaxhimit të riskut dhe pozicionin e saj të tanishëm dhe të ardhshëm të aftësisë paguese, në rastet normale të funksionimit dhe në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme (stress testing).

Struktura e Menaxhimit të Riskut të Shoqërisë

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është struktura përgjegjëse e monitorimit të riskut. Gjithashtu, struktura përfshin edhe një Komitet të Menaxhimit të Riskut, i miratuar nga Bordi i Drejtoreve.

Vetevlerësimi i Risqeve dhe Aftësisë Paguese

Procesi i vetevlerësimit të Risqeve dhe aftësisë paguese të shoqërisë përbehet nga disa faza:

- i. Procesi i Kontrollit të Risqeve
 - a. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve
 - b. Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ
 - c. Monitorimi, masat dhe kontrollet
 - d. Raportimi
- ii. Prova e Rezistencës
- iii. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese
- iv. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij
- v. Profili i Përgjithshëm i Riskut

Procesi i Kontrollit të Risqeve

Procesi i kontrollit të risqeve fillon me inventarizimin e tyre. Duke u bazuar në template të Vienna Insurance Group ("Shoqëria meme"), kemi bërë inventarizimin e risqeve kryesore të shoqërisë. Për çdo risk të identifikuar është bërë vlerësimi frekuencë/shkallë e rëndësie, mënyrën që ata përdorin për vlerësimin e riskut dhe masat/kontrollet e ndermarra për secilin risk, nëse ka të tilla të nevojshme.

Prova e Rezistencës

Prova e rezistencës është një teknikë e cila përdoret për të matur ndjeshmerinë ndaj ngjarjeve që kanë një probabilitet të vogël për të ndodhur, por që kanë një efekt të konsiderueshëm kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore të këtij testimi janë analiza e ndjeshmerisë dhe analiza e skenareve.

Faktoret makroekonomike kanë një efekt të madh në këto lloje testimi. Risqet si ato të tregut, të kreditit apo operacionale janë drejtperdrejtë të lidhur me luhatjet në normat e interesave, cmimet e asetëve, dhe kursin e këmbimit.

RISIGURIMET

NJË INSTRUMENT I DOMOSDOSHËM

Risigurimet janë një nga hallkat më të rëndësishme të kompanive të sigurimit, e cila ndihmon në rritjen e aftësisë paguese të kompanisë në rastin e ndodhjes së dëmeve të mëdha, siç kanë qenë dhe ato të dy tërmete të ndodhura në fund të vitit 2019. Kompania jonë, ka arritur të ketë një plan risigurimi të mirëmenduar dhe në këtë mënyrë arriti të dëmshpërblejë klientët e dëmtuar në kohë rekord, duke ruajtur kështu edhe qëndrueshmërinë e kompanisë.

Zgjedhja e kompanive risiguroese, është gjithnjë shumë e rëndësishme, jo vetëm për shkak të garancisë që ju ofrohet klientëve por edhe për shkak të asistencës dhe njohurive teknike të ofruara gjatë trajtimit të dëmit, si nga pikëpamja teknike ashtu dhe ajo menaxhimit të kërkesave për dëm, të cilat në rastin e katastrofave kanë një fluks shumë të madh brenda një periudhe të shkurtër kohe.

Në këtë kontekst, Sigma Inter Albanian VIG, duke pasur edhe suportin e kompanisë mëmë Vienna Insurance Group, ka investuar në përzgjedhjen e partnerëve të fuqishëm për transferimin e riskut, të cilët ofrojnë një mbulim të plotë në raste dëmsh, qofshin ato individuale apo katastrofike, por gjithashtu ofrojnë një kontribut mjaft me vlerë në trajnimin e stafit për përballimin e situatave të vështira.

Padyshim që pandemia ka goditur dhe tregun e sigurimeve ashtu si dhe të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë. Produktet e sigurimit të Jo Jetës në Shqipëri ofrojnë mbulim për risqe të caktuara dhe si të tilla, pandemia nuk ka qenë e ofruar në asnjërën prej tyre.

Aktualisht, Sigma Inter Albanian VIG ka në marrveshjen e saj të risigurimit, kompani risigurimi të klasit të parë, të cilët kanë dhe vlerësimin më të lartë nga Standards and Poors.

VIG RE	A(+)
Munich Re	AA-
Swiss Re	AA-
Allianz	AA
Hannover Re	AA
DVECK	A+
CHUBB European Group	AA
ROYAL & SUN ALLIANCE	A
Lloyd's Underwriters	A+

PARIMI i MENAXHIMIT TË RISKUT

Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftesise Paguese

Bazuar ne ligjin nr. 52/2014 date 22.05.2014, "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit", shoqeria duhet te mbaje nje fond garancie minimum ne shumen 370 milion leke (ose jo me pak se 1/3 e marzhit te aftesise paguese minimale).

Plani i Vazhdimesise se Aktivitetit dhe Testimi i Tij

Plani i vazhdimesise se aktivitetit eshte formuluar dhe eshte perditesuar nga shoqeria per tju pershtatur ndryshimeve ne strukturen e shoqerise. Ne plan parashikohen hapat qe duhet te ndermerren ne rast te llojeve te ndryshme katastrofash, si dhe percaktohen personat pergjegjes per grupet e ndryshme te punes.

Profili i Pergjithshem i Riskut dhe Konkluzioni

Duke konsideruar te gjithe analizen e mesiperme dhe gjetjet e rezultuara, arrijme ne perfundimin qe shoqeria ka nje nivel menaxhueshem te riskut ne teresi.





1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Qellimi i procesit te inventarizimit eshte identifikimi dhe kategorizimi i Risqeve.

Risqet kryesore te identifikuar nderkombetare jane:

- Risku i Tregut
- Risku i Marrjes ne Sigurim se Jo-jetes
- Risku i Marrjes ne Sigurim se Produktit te Shen-detit
- Risku i Aktiveve te Patrupezuar
- Risku i Falimentimit te Pales Tjeter
- Risku i Likuiditetit
- Risku Operacional
- Risku i nderprerjeve te aktivitetit
- Risku i perqendrimit te njohurive
- Risku i burimeve njerezore te pamjaftueshme
- Risku i hardware dhe infrastruktures
- Risku i software dhe i sigurise
- Risku i modelimit dhe kualitetit te te dhenave
- Risku i zhvillimit te IT
- Risku i projekteve
- Risku i perputhshmerise ligjore te lidhura me sigurimet
- Risku i perputhshmerise ligjore te tjera
- Risku i proceseve dhe organizimit
- Risku i gabimeve njerezore
- Risku Strategjik
- Risku i Reputacionit

2. Vleresimi kualitativ ose kuantitativ

Ne kete proces behet vleresimi i risqeve materiale. Vleresimi behet ne baze te dy parimeve : frekuenca dhe shkalla e rëndesise.

3. Monitorimi, masat dhe kontrollet

Monitorimi i te gjithë risqeve eshte i detyrueshem dhe kryhet te pakten nje here ne vit.

Ne kete proces monitorimi merr rëndesi vleresimi i bere i riskut dhe ndarja sipas shkalles se rrezikut.

4. Raportimi

Raportimi tek Bordi i shoqerise permban nivelet e risqeve dhe masat qe duhen marre per ato risqe te klasifikuara shqetesuese.



Gjithashtu puna audituese eshte perqendruar në zbatimin e urdhrave dhe udhezimeve te brendshme te Bordit Drejtues lidhur me menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve te shitjes. Lidhur me kete problem rekomandime jane dhene kryesisht ne permiresimin e programit informatik MBA per rregjistrimin, dhe rakordimin informatik te te dhenave te komisioneve e te bonuseve te shitjes.

Kontrollet e shitjes se produkteve te detyrueshme, TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare janë perqendruar me se shumti tek risqet e mundshme qe shfaqen si pasoje e gabimeve ne rregjistrimet e policave ne programin e shitjes MBA, ne shitjen policave vetem nepermjet programit informatik per te gjitha llojet e produkteve te licensuara dhe ne saktesine e te dhenave lidhur me kategorine e automjetit, periudhen e mbulimit te sigurimit etj.

Veprimtaria e Aktiviteteve te shitjes dhe te kontrollit te brendshem te shitjes per vitin 2021 eshte kryer ne perputhje me kerkesat ligore dhe rregullatore te kerkuara nga AMF dhe nga vete shoqeria SIVIG. Performanca e realizimit per te ardhurat nga primet e shkruara bruto per vitin 2021 ka qene e kenaqeshme me nje rritje vjetore ne masen 15.9 % krahasuar me vitin e kaluar.

Aktivitetet e Trajtimit te Demeve, Auditimet e realizuara gjate vitit 2021 jane fokusuar ne perputhshmerine me kuadrin ligjor ne fuqi, me rregulloret e AMF dhe me rregulloret e brendshme te miratuara nga shoqeria.

Kontrollet e njesise se Auditimit te Brendshem gjate vitit 2021 kane synuar te mbulojne te gjitha klasat e demeve te raportuara, si ato materiale, motorrike (Kasko, TPL, Karton Jeshil); demet e prones, ashtu edhe demet jo-materiale, shendetsore nga TPL, si dhe demet e sigurimit privat te shendetit etjera. Kontrollet e kryera ne Departamentin e Demeve, VIG Services, jane fokusuar ne korrektesine e ekspertimit dhe ne saktesine e vleresimin te demeve; ne funksionimin e kontrollit te proceseve brenda departamentit; ne kohezgjatjen e trajtimit te demeve dhe ne kujdesin per klientin. Departamenti i Demeve ashtu si per vitin 2020 edhe per vitin 2021 vemendje dhe rrisht te shtuar ka patur lidhur me trajtimin dhe pagesat e demeve te prones dhe te kujdesit ndaj klientit, sidomos per pronat e demtuara nga termeti i vitit 2019.

Gjate auditimeve jane kontrolluar si te dhenat ne databazen elektronike, rregjistrimet ne programin e demeve MBA dhe dokumentat e skanuar elektronikisht, ashtu edhe dokumentacioni fizik i arkivuar i dosjeve te demeve te paguara.

Kontrollet ne trajtimin e demeve materiale nga produktet e detyrueshme kane konsistuar ne afatet e rregjistrimit dhe trajtimit te demit ne perputhje me rregulloret e AMF; problematikave lidhur me funksionimin dhe permiresimin e programit informatik te trajtimi te demeve; ne referencat dhe manualet e cmimeve te perdorur per vleresimin e sakte dhe te drejte te demeve: kryerjes ne kohe te pageses se demshperblimit dhe: te kujdesit ndaj klientit lidhur me te dhenat personale dhe me ankesat e tyre.

AUDITIMI I BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE PËR VITIN 2021

Auditi i Brendshem i shoqerise SigmaInteralbanian gjate vitit 2021 ka kryere aktivitetin e kontrollit te auditimit te brendshem te veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Planin Vjetor te Auditimit 2021 te miratuar nga Keshilli Mbikqyres i shoqerise ne muajin Dhjetor 2020, si dhe ne planin afat gjat tre vjecar 2021-2023, te miratuar nga Departamenti i Auditit te Brendshem i Grupit VIG Austria ne muajin Nentor 2020. Gjate vitit 2021 jane kryer edhe kontrole te inicuar nga ana e Drejtorit te Pergjithshem ose/dhe te Bordit Drejtues te Shoqerise per probleme te ndryshme.

Kryerja e angazhimeve audituese gjate vitit 2021 ne shoqerine e sigurimit SigmaInteralbanian VIG eshte bazuar ne kornizen rregullatore te perbere nga: - Legjislacioni i AMF per veprimtarine e Sigurimeve dhe Risigurimeve :- Dokumenti "Parimet kryesore te Auditit te Brendshem te Vienna Insurance Group":- Rregullorja Nr.153 e Autoritetit te Mbikqyrjes Financiare "Për veprimtarinë e Njesise së Auditimit te Brendshem dhe Komitetit te Auditimit në shoqerine e sigurimit ": - Karta e Auditit te Brendshem dhe : - Manuali i Auditit te Brendshem.

Gjate vitit 2021 Auditimi i Brendshem i shoqerise eshte perqendruar kryesisht ne auditimin e aktiviteve te Shitjes ; te Demeve ; te Administrimit financiar dhe te kontabilitetit; si dhe ne ato te ; Marrjes ne sigurim: të Menaxhimit te riskut: te Risigurimeve, dhe : te Teknologjise se Informacionit. Bazuar ne strukturen organizative dhe organigramen e shoqerise, auditimet e kryera jane bere duke perfshire departamentet ne zyrat qendrore, ne departamentet perkatese te Vig Services, dhe ne deget ,agjentet shoqërisë dhe te ndermjetesve te tjere te shitjes, kjo me qellimin per te mbuluar plotesisht te gjitha fushat e veprimtarisë se shoqerise.

Funksionet e trajtimit te demeve, te kontabilitetit dhe te teknologjise se informacionit jane transferuar ne nje kompani sherbimi, VIG Services Shqiperi. Kriteret e ofrimit te sherbimeve te transferuara dhe treguesit e performances jane te percaktuara ne Marreveshjen e Nivelit te Sherbimit (SLA Agreement) ndermjet shoqerise Sigma Interalbanian VIG dhe VIG Services Shqiperi. Kjo marreveshje eshte perdituesuar ne muajin Tetor 2017 dhe per pjese te vecanta, perdituesohet ne menyre te vazhdueshme.

Aktivitetet e Shitjes drejtohen nga Departamenti i Shitjes ne Drejtorine e Pergjithshme dhe permbushen nga Zyra Qendrore, nga Deget e Shitjeve dhe Ndermjetesit e licensuar te shitjes te shoqerise Sigma Interalbanian VIG.

Kontrollet e Auditit te Brendshem per vitin 2021 ne aktivitetet e shitjes jane fokusuar ne zbatimin te kerkesave ligjore te AMF, te zbatimit te rregulloreve te brendshme te shoqerise, per rregjistrimin e sakte dhe pa vonesa te policave te sigurimit ne programin e shitjes, arketimin e primeve vecanerisht per produktet vullnetare, menaxhimin e llogarive te parardenieve per shitjen, duke u bazuar edhe ne kerkesat e Autoritetit te Mbikqyrjes Financiare per rregjistrimin dhe raportimin ne kohe reale te policave te sigurimit te detyrueshem.

Departamenti i Teknologjise se Informacionit gjate vitit 2021 eshte audituar lidhur me shfrytezimin e sistemeve dhe programeve informatike ne perputhje me rregulloren e brendshme, per ruajtjen dhe sigurne e te dhenave si dhe te permiresimit softuerik te programit MBA te shitjes, administrimit dhe te trajtimit te demeve. Auditime jane kryere per proceset si: ne vendosjen dhe aplikimin e sakte te hierarkise se te drejtave te perdoruesve, per rinovimin e pajisjeve hardware dhe perditesimin e licencave ne perdorim, dhenien e suportit IT per te gjitha perdoruesit e sherbimeve (punonjesit) si dhe mirembajten e sistemeve te sigurise te instaluara ne ambientet e shoqerise.

Departamenti i Ri-sigurimeve, Gjate auditimit te kryere ne kete department ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar ne Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit", ne Rregulloren e Grupit VIG per Risigurimet dhe ne marreveshjet e lidhura ndermjet shoqerise dhe risiguruesve perkates. Partneri kryesor i shoqerise per aktivitetin e risigurimeve eshte VIG-RE i cili eshte pjese e Vienna Insurance Group. Partneret e tjere jane perzgjedhur dhe miratuar bazuar ne rankimet nderkombetare te institucioneve nderkombetare per shoqerite e risigurimeve. Lista e risiguruesve eshte perditesuar periodikisht ne perputhje me rregulloren e brendshme te Grupit VIG.

Kontrollet e auditit te brendshem per vitin 2021 kane konsistuar ne perpushmerine ligjore dhe te zbatimit te rregulloreve ne fuqi, per njoftimin ne kohe dhe miratimine dhene nga ana e Departamentit te Risigurimeve te Grupit VIG, lidhur me risqet e mundshme dhe percaktimin e ofertave. Departamenti i Risigurimeve ne perpunimin dhe nxjerjen e te dhenave bashkepunon dhe rakordon me departamentet e tjere si departamenti i Shitjes, Marjes ne sigurim, Aktuarit, Demeve, Kontabilitetit etjera. Gjithashtu jane audituar raportimet periodike ne Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe në Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Departamentit Ligjor, Veprimtaria e ketij departamenti eshte fokusuar ne perfaqesimin dhe mbrojtjen e shoqerise ne proceset gjyqesore me objekt trajtimin e demeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato te fondit te kompensimit. Gjithashtu pjese e aktiviteteteve juridike te shoqerise jane ndjekja dhe mbeshtetja per grumbullimin primeve te paarketuara nga klientet dhe subjektet debitore. Kontrollet e kryera nga Auditi i Brendshem ne aktivitetet juridike te shoqerise gjate vitit 2021 jane fokusuar ne percaktimin dhe vleresimin e risqeve qe mund te vijne ne nga zgjidhja me proces gjyqesor e mosmarreveshjeve.

Aktivitetet e administrimit financiar; dhe te kontabilitetit e raportimit financiar . Nisur nga fakti qe departamenti i Administrimit financiar e kryen veprimtarine e vet ne zyrat e qendrore te kompanise Sigmalnterlbanian, kurse departamenti i Kontabilitetit dhe Raportimit financiar te shoqerise e kryen veprimtarine e tij ne kompanine e sherbimit Vig Services, Auditimi per vitin 2021 eshte kryere duke u fokusuar ne temat si:- Ne funksionimin e programit MBA per administrimin e policave (rregjistrimi dhe raportimi ne nivel police, i primeve, arketimeve, debitoreve, komisioneve dhe inventarit); - si dhe ne llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve ne perputhje me urdhrat e brendshme te Bordit te Drejtoreve te Shoqerise; - ne zbatimin e procedurave per leshimin e policave dublikate dhe per anullimin e policave, si dhe :- ne rakordimet mujore te agjenteve te shitjes me deget dhe me drejtorine e pergjitheshme lidhur me kontrollin, analizimin e rakodrimin e : primeve totale te shitjes, primeve te arketuara, balancat debitore noftimin e ndjekjen e procedurave per arketimin e primeve te paarketuara (policat debitore).

- ne kontrollin e inventarimin fizik te policave gjendje te furnizuara tek agjentet e shitjes; grumbullimin dhe dorezimin ne Byro te policave te detyrueshme TPL, KJ dhe KUF (polica te furnizuara gjate vitit ushtrimor, dhe polecat e sigurimit te pashitura deri ne fund te vitit);

Administrimi kontabel i shoqerise eshte audituar per saktesine e rregjistrimeve ne programin e kontabilitetit SAP tek VIG Services. Ne departamentin e Kontabilitetit ne Vig Services jane bere kontrollet lidhur me saktesine e regjistrimeve ne programin SAP, te primeve te shkruara, te primeve te arketuara, dhe te balancaave te hapura debitore per primet e pa arketuara, ne nivel kompanie, degeve, agjenteve e ndermjetesve te tjere te shitjes. Jane kontrolluar per rakordimet mujore e vjetore qe departamenti i Kontabilitetit ben me departamentin e Administrimit financiar per treguesit e te dhenat e permendur me larte.

Rakordimet kane qene te dakortesuara dhe te miratuara me shkrim nga te dyja departamentet. Jane kontrolluar si edhe per raportimet brenda afateve ne insitucionet jashte shoqerise (AMF, DPT, Drejtoria e Pastrimit te Parave etj), si dhe raportimet e brendshme per Departamentet e tjera, Bordin Drejtues dhe Keshillin Mbikqyres etj.

Aktivitetet e Marrjes ne Sigurim dhe Menaxhimit te Riskut gjate vitit 2021 kane funksionuar te harmonizuara me njera tjetren. Departamenti i Marrjes ne sigurim per vitin 2021 ka realizua aktivitetin e saj per marjen ne sigurim keyesisht te pronave dhe te produkteve te tjera vullnetare te shitura nepermjet tenderave, bazuar ne njohjen paraprake te pronave, ose te biznesit per tu mare ne sigurim, dhe me tej ne analizen e klientit per cdo subjekt juridik, apo subjekt fizik. Departamenti marjes ne sigurim vemendje te shtuar i ka kushtuar rekomandimit per risigurim te pronave kur shuma sigururse e tyre eshte me nivele me te larta se limitet e mbajtjes se kompanise. Per cdo rast te marjes ne sigurim Komiteti i Menaxhimit te Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen ne sigurim dhe ofertat per percaktimin e primit ne perputhje me rregulloren e brendshme dhe urdherat e Bordit te Drejtoreve te nxjerra per kete qellim. Shoqeria i ka kushtuar vemendje dhe ka permiresuar dokumentacionin e nevojshme per analizimin e risqeve te marrjes ne sigurim te pronave.

OBJEKTIVAT 2022

Shëndeti dhe siguria e punonjësve ka qënë në fokus të aktivitetit të kompanisë edhe gjatë vitit 2021. Duke qënë se vëmendja e të gjithëve u përqëndrua tek siguria dhe shëndeti, një ndër objektivat e vitit 2022 ishte rritja e shitjeve nga sigurimet vullnetare, duke ndihmuar kështu në përmirësimin e cilësisë së jetës së klientëve tanë dhe duke ju dhuruar atyre qetësi në rast të ndodhjes së ngjarjeve të papritura.

Digjitalizimi i proceseve në shërbim të klientit, vazhdon të mbetet një tjetër objektiv po aq i rëndësishëm sepse është një ndër prioritetet e grupit VIG, kështu që edhe ne kemi synim të ecim me të njëjtin hap në këtë drejtim. Është punuar fort që të kemi një version të përmirësuar të aplikacionit SIVIG për celular si dhe shitjen online nëpërmjet ëeb dhe aplikacionit. Gjithashtu, gjatë vitit 2022 do të punohet që bëhet i mundur telemjekësia nëpërmjet aplikacionit, dhe klientët e SIVIG do të aksesojnë doktorin nëpërmjet aplikacionit SIVIG.

Gjatë vitit 2022 synohet të arrihet trajtimi i dëmeve motorike në një kohë më të shkurtër si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve të mundshme pa ndërmbetës dhe pa proces gjyqësor, i cili është i mundimshëm dhe i kushtueshëm për të dyja palët.

Kanalet tradicionale të shitjes janë një metodë shumë e suksesshme në Shqipëri, ndaj synojmë të rrisim prezencën gjeografike me degë dhe agjensi edhe në zonat ku nuk kemi qënë prezent deri tani. Por, ne synojmë të shkojmë më pranë klientit nëpërmjet kanaleve alternative.

Gjithsesi, zhvillimi i vitit financiar 2022, do të ndikohet nga faktorë pasigurie, për shkak të luftës në Ukrainë dhe efekteve të paparashikueshme që mund të ketë. Pandemia që ende nuk ka përfunduar, inflacioni, rritja e cmimeve të mallrave dhe shërbimeve, janë rreziqe të shtuara që mund të ndikojnë në tregun e sigurimeve por edhe në arritjen e objektivave të kompanisë.

Opinion i shkurtuar i Auditit të Brendshëm për vitin 2021

Auditimet dhe kontrollet e brendshme të realizuara gjatë vitit 2021 kanë mbuluar të gjitha aktivitetet e shoqërisë në përputhje me planin vjetor të auditimit. Angazhimet audituese janë finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë pasqyruar në raportet e auditimit të dërguara në Bordin Drejtues të Shoqërisë Sigma InterAlbanian VIG, dhe në mënyrë të përmbledhur në Keshillin Mbikqyres të saj.

Drejtuesi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Komitetin e Auditimit dhe Bordin Drejtues, duke marrë mbështetje të plote për realizimin e rekomandimeve. Në mënyrë të vazhdueshme Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve të miratuara si dhe statusin përfundimtar të tyre.

Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit, Auditimi i Brendshëm shpreh siguri të arsyeshme që aktivitetet e shoqërisë Sigma-InterAlbanian VIG gjatë vitit 2021 janë kryer në përputhje të plote me kuadrin ligjor për tregun e sigurimeve në Shqipëri.

Thëksojmë se në angazhimet tona audituese gjatë vitit 2021 nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale, të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e shoqërisë.

Diversiteti i Punonjësve	Të rekrutohet nga një grup kandidatësh të kualifikuar dhe të ndryshëm, që të rritet diversiteti i të menduarit dhe i këndvështrimit.
Përfshirja në vendin e punës	Të inkurajohet përfshirja e punonjësve në procese të ndryshme, sepse nëse ata ndihen të përfshirë, bëhen më të vlefshëm dhe do të përkushtohen më shumë ndaj kompanisë.
Diversiteti në Biznes	Të krijohen produkte që të jenë të përshtatshme për grupe dhe biznese të ndryshme. Të rritet baza e furnitorëve, duke konsideruar edhe bizneset e vogla.

Rolet dhe përgjegjësitë:

- Punonjësit janë përgjegjës që të mbajnë një ambjent pune të sigurt, produktiv dhe ku respektohen të gjithë.
- Të gjithë kanë të drejtë të trajtohen sic duhet në vendin e punës, i cili është një vend që e njeh dhe pranon diversitetin.
- Të gjithë mund të marrin pjesë në aktivitetet që kryhen për inkurajimin e përfshirjes dhe diversitetit në kompani, në përputhje me rregulloret kundër diskriminimit.
- Drejtuesit dhe menaxherët mund të kontribuojnë duke treguar një përkushtim pozitiv për përfshirjen dhe diversitetin, duke u bërë kështu model i një kulture pune në të cilën të gjithë janë të përfshirë, të krikojnë sjelljet e papërshtatshme si dhe të marrin pjesë në trajnimet e diversitetit dhe të inkurajojnë dhe pjestarët e ekipeve të tyre që të jenë edhe ata pjesë.
- Suksesi i strategjisë varet nga mbështetja që i bëhet të gjithëve në department. Secili ka përgjegjësinë që të kontribuojë për një kulturë që mbështet dhe vlerëson diversitetin dhe përfshirjen.

Koncepti i Diversitetit - Sigma InterAlbanian VIG

QËLLIMI YNË

Sigma InterAlbanian VIG ka si qëllim që të ofrojë një vend pune në të cilën kolegët ndihmojnë dhe mbështesin njëri tjetrin, ku cdonjëri ndihet i mirëpritur, i përfshirë, i vlerësuar dhe i respektuar pavarësisht ndryshimeve që ata mund të kenë me të tjerët. Ata duhet të ndihen të nxitur që të shprehin versionin më të mirë të vetes së tyre në mënyrë që të ndihmojnë kompaninë të arrijë targetin e saj. Klientët tanë janë të gjithë të ndryshëm, prandaj dhe diversiteti ynë mund t'i ndihmojë ata që të gjejnë në kompani personin të cilit ndiejnë se mund t'i besojnë më shumë. Punonjësit, të cilët vijnë nga realitete të ndryshme, frymëzojnë kompaninë me ide dhe perspektiva të reja dhe kreative, të cilat mund të vijnë nga kultura e tyre dhe eksperiencat që mund të kenë pasur. Kjo na ndihmon të kuptojmë më mirë edhe kërkesat e klientëve dhe të krijojmë produkte që ju përshtaten më mirë atyre. Ndjesia e lidhjes së një punonjësi me kompaninë ndërtohet mbi përkatësinë – pra ti ndjen që je pjesë e një ambjenti që të njeh dhe të vlerëson.



aloDoktor


Vetëm
20€/ vit

Konsulencë
nëpërmjet telefonit 24/7

Mbulim shpenzimesh deri në 3.000 Euro.
Zbritje në rrjetin e spitaleve të SIVIG

SIGMA 
INTERALBANIAN
VIENNA INSURANCE GROUP

 www.sivig.al

 +355 69 407 3849

 Klienti@sivig.al

Me Sigma InterAlbanian themi “Alo Doktor” në çdo moment

Megjithëse telemjekësia po konsiderohet si e ardhmja e mjekësisë, për SIGMA-n, ajo është e tashmja. Sot, jo të gjithë kanë mundësi të shkojnë tek doktori. “Alo Doktor” është një projekt social i kompanisë Sigma InterAlbanian, me anë të të cilit synojnë që t’u japë akses në mjekësi të gjithë personave, kudo që ata ndodhen. Këtë produkt mund ta blejnë, jo vetëm ata që jetojnë në Shqipëri, në qytete të zhvilluara dhe zona rurale, por edhe emigrantët për prindërit e tyre. Mund ta marrin gjithashtu dhe personat që jetojnë jashtë, por nuk dinë ende gjuhën vendase. Imagjini lehtësinë që mund të ndjeni, nëse gjatë një udhëtimi jashtë Shqipërisë ju kapin dhimbje të forta. Jo vetëm nuk dini se ku të drejtoheni, por edhe nëse dini ilaçin që duhet të merrni, farmacitë nuk ua japin atë pa një recetë. Nëpërmjet aplikacionit, receta vjen menjëherë në telefonin tuaj, si dhe çdo rekomandim për të kryer ekzaminime të tjera shtesë. I gjithë historiku i komunikimeve me mjekun, ruhet në rekorde të veçanta, në të cilat keni akses në çdo kohë.

Garancia dhe eksperiencia austriake e ngre këtë produkt në një tjetër nivel. Shumë shpejt do të jetë mundësia që nëpërmjet këtij aplikacioni të kontaktohen edhe mjekë specialistë austriakë nëse lind nevoja për një opinion tjetër, pa qenë nevoja të jemi fizikisht në Austri.

Me anë të produktit “ALO DOKTOR”, ju do të keni mundësinë që të bëni konsulta me mjekun e përgjithshëm, pa një vizitë personale fizike në klinikë apo spital. Shëndetësia digjitale zhvillohet nëpërmjet internetit për të gjithë personat që kanë qasje në internet në kompjuterin, tabletin ose smartphonin e tyre.

Disa nga shërbimet e shëndetësisë digjitale

Pacientët mund të përdorin aplikacionin për:

- Konsulta drejtpërdrejt përmes telefonit ose biseda video me mjekun;
- Dërgim dhe marrje të mesazheve nga mjeku, foto (receta për medikamente apo rekomandime për ekzaminime).
- Rregullim i dozave të medikamenteve ekzistuese sipas rastit;
- Këshilla si të menaxhosh një situatë shëndetësore në shtëpi;
- Këshilla për një jetë të shëndetshme;
- Shëndetësia digjitale është veçanërisht e dobishme për të monitoruar dhe përmirësuar çështjet e vazhdueshme shëndetësore, të tilla si ndryshimet e ilaçeve ose kushtet kronike të shëndetit.

Në këtë periudhë, kur kemi kuptuar rëndësinë e shëndetit, të kesh mundësinë të kontaktosh një mjek në çdo moment, është jo vetëm një lehtësi e madhe, por edhe një garanci për një jetë të shëndetshme.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. (më poshtë "Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukseve të parasë për vitin e mbyllur më atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF-të").

Baza për opinionin

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA"-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) ("Kodi i BSNEPK") dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë ("Kodi IEKA"), së bashku me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar, që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK dhe Kodin IEKA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 janë audituar nga një tjetër auditues i cili ka lëshuar një opinion të pamodifikuar më 1 qershor 2021.

Informacione të Tjera të Përfshira në Raportin Vjetor 2021 të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Shoqërisë për vitin 2021, përgatitur në përputhje me nenet 17 dhe 19 të Ligjit Nr. 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Shoqërisë për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a., përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

9 qershor 2022
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Mario Vangjel".

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVET			
Aktive afatgjata materiale	11	307,754	311,654
Aktive afatgjata jo-materiale	12	53,157	57,434
Aktive të mbajtura për investime	13	281,828	68,500
Aktive me te drejte perdorimi	14	51,025	311,113
Aksione në shoqëri të lidhura	15	20,543	20,543
Aktive të risigurimit	16	2,555,850	2,671,737
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	17	3,312,062	2,856,970
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm		4,544	1,809
Depozita me afat me bankat	18	1,999,242	2,036,769
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	19	379,532	349,018
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	20	256,514	207,456
Aktive të tjera	21	145,240	131,114
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara	22	315,406	305,494
TOTALI I AKTIVEVE		9,682,697	9,329,611
KAPITALI			
Kapitali aksionar	23	498,213	498,213
Rezerva e rrezikut të sigurimit dhe ligjore	24	594,192	594,192
Rezerva e rivlerësimit	24	56,727	60,706
Rezerva e bashkimit	24	333,207	333,207
Rezerva e përkthimit		(45,400)	(26,544)
Fitime të pashpërndara		558,019	390,379
TOTALI I KAPITALIT		1,994,958	1,850,153
DETYRIMET			
Detyrime për kontratat e sigurimit	25	3,988,344	3,945,765
Rezerva për primet e pafituara	30	1,732,959	1,635,449
Detyrime tatimore të shtyra	39	5,802	6,503
Detyrime tatimore dhe të tjera të ngjashme	26	31,252	32,245
Detyrim per qira afatgjate	14	291,481	318,570
Depozita e risiguresit	27	1,276,963	1,244,524
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	28	360,938	296,402
TOTALI I DETYRIMEVE		7,687,739	7,479,458
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		9,682,697	9,329,611

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga bordi drejtues i Shoqërisë më datë 19.05.2022, dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Klaidi Çitozi
Drejtor i Përgjithshëm



Ilir Elmazi
Drejtor Ekzekutiv i VIG Services

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.
Pasqyra e e fitim ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Prime të shkruara bruto	29	3,773,098	3,510,487
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara bruto	30	(111,163)	(39,378)
Te ardhura nga primet e sigurimit		3,661,935	3,471,109
Prime të çeduarda të risiguruesit	31	(1,721,489)	(1,594,457)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara	30	63,180	(11,697)
Të ardhura të primit të sigurimit të çeduarda te risiguruesi		(1,658,309)	(1,606,154)
Të ardhura neto nga primet e sigurimit		2,003,626	1,864,955
Të ardhura nga komisionet e risigurimit	32	710,501	654,120
Të ardhura nga investimet	33	161,834	156,798
Të ardhura të tjera		10,355	3,670
Të ardhura neto		2,886,316	2,679,543
Dëme të paguara bruto	25	(1,855,469)	(1,610,571)
Dëme të paguara nga risiguruesi	25	879,294	697,910
Ndryshimi në rezervën e dëmeve bruto	25	(72,287)	(468,666)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të risiguruesit	25	(165,692)	272,124
Dëmet neto të sigurimit dhe përfitime		(1,214,154)	(1,109,203)
Shpenzimet të marrjes në sigurim	34	(729,670)	(688,300)
Shpenzime administrative	35	(608,630)	(572,858)
Shpenzime të tjera sigurimi	36	(42,883)	(39,500)
Shpenzime		(1,381,383)	(1,300,658)
Të ardhura nga kurset e këmbimit, neto	37	3,538	(12,734)
Shpenzime financiare	38	(21,767)	(21,196)
Fitim/(humbje) para tatimit		272,750	235,752
Tatimi mbi fitimin	39	(41,288)	(43,402)
Fitim/(humbje) e vitit		231,462	192,350
Zërat që nuk do të riklasifikohen në fitim ose humbje:			
<i>Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse, neto nga taksat</i>		(18,856)	(18,895)
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		212,606	173,455

Shenimet shoqeruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e sigurimit	Rezerva e bashkimit	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e përkthimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2020	498,213	171,792	333,207	64,683	(7,649)	616,452	1,676,698
Riklasifikimi i rezervës së kapitalit së Degës së Kosovës	-	422,400	-	-	-	(422,400)	-
Gjendja më 1 janar 2020 (e riklasifikuar)	498,213	594,192	333,207	64,683	(7,649)	194,052	1,676,698
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	192,350	192,350
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	-	(18,895)	-	(18,895)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	(18,895)	192,350	173,455
Transferimi i amortizimit për ndërtesat	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	498,213	594,192	333,207	60,706	(26,544)	390,379	1,850,153
Gjendja më 1 janar 2021	498,213	594,192	333,207	60,706	(26,544)	390,379	1,850,153
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	231,462	231,462
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksa	-	-	-	-	(18,856)	-	(18,856)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	(18,856)	231,462	212,606
Transferimi i amortizimit për ndërtesat	-	-	-	(3,979)	-	3,979	-
Shpërndarja e dividendit	-	-	-	-	-	(67,801)	(67,801)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	498,213	594,192	333,207	56,727	(45,400)	558,019	1,994,958

Shenimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e flukseve monetare

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	272,750	235,752
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit		
<i>Rregullime për:</i>		
Zhvlerësimi	11,12	107,321
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve të mbajtuara për investime	13	4,350
Zhvlerësimi për sigurimet e arkëtueshme	20	6,209
Shpenzime interesi	38	21,194
Të ardhura nga investimet	33	(160,363)
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrime	245,717	184,139
Ndryshime në të arkëtueshmet nga sigurimi e të tjera	(56,733)	75,258
Ndryshime në aktivet e tjera	(6,530)	2,654
Ndryshime në aktive të risigurimit	99,669	(234,315)
Ndryshime në kostot e shtyra të marrjes së sigurimit	(31,881)	4,011
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit	72,287	486,246
Ndryshime në rezervën për primet e pafituara	111,164	47,212
Ndryshime në depozitat e risigurimit	41,154	56,584
Ndryshime në detyrime të tjera	(8,148)	(25,242)
Ndryshime në të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	67,174	50,923
Ndryshime në mjete monetare të kufizuara	6,312	10,813
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit përpara interesave dhe taksës	540,185	658,283
Interesi i arkëtuar	143,386	126,914
Interesi i paguar	(16,964)	(14,749)
Tatim fitimi i paguar	(46,443)	(47,015)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit	620,164	723,433
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale e jo-materiale	11,12	(26,835)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuara	(450,712)	(637,811)
Rënie në depozitat me afat	2,242	(5,116)
Rritje në aksione në shoqëri të lidhura	-	(5,889)
Flukset monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese	(475,305)	(675,270)
Flukset monetare nga aktivitetet finacuese		
Qira të paguara	(62,051)	(58,820)
Dividend i paguar	(64,187)	-
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet finacuese	(126,238)	(58,820)
Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to	18,621	(10,657)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fillim të vitit	294,681	312,762
Efekt i kursit të këmbimit në mjetet monetare	(2,397)	(7,424)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fund të vitit	22	294,681

Shenimet shoqeruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e ketyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nga Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. ("Shoqëria" ose "SIVIG") si pasqyra financiare ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF").

"SigmaInterAlbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a ("Shoqëria" ose "SIVIG" e njohur më parë si Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a ose SIGMA) është themeluar në 1999 dhe regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë ndryshoi në Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. pas bashkimit me përthithje të InterAlbanian SH.A., degë e Vienna Insurance Group.

Shoqëria mëmë e Shoqërisë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri, e cila zotëron 89.05% të aksioneve. Pala kontrolluese përfundimtare e Grupit është Wiener Städtische Wechselseitiger Versicherungsverein - Vermögensverëaltung - Vienna Insurance Group, Vjenë, Austri.

Aktiviteti kryesor: Aktiviteti kryesor i Shoqërisë përfshin sigurimin e ekspozimeve për mjetet motorike, pasuritë, shëndetin dhe produkte të tjera të ndryshme të sigurimit të jo – jetës në Shqipëri dhe Kosovë. Operacionet në Kosovë menaxhohen prej degës së shoqërisë

Aktiviteti i Shoqërisë në Shqipëri është subjekt i ligjit nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Mbi sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimi" ("akti i sigurimit"). Rregullatori i tregut të sigurimeve në Shqipëri është Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (në vijim "Autoriteti" ose "AMF").

Dega është themeluar më 11 tetor 2004 dhe operon me licencë të lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për të siguruar sigurimin e përgjithshëm të rrezikut të jojetës në Republikën e Kosovës sipas dispozitave të Ligjit të Sigurimeve të Kosovës, Ligji nr. 05/L045 "Për Sigurimet". Dega gjithashtu duhet të depozitojë një shumë minimale prej 3,200 mijë euro në formën e kapitalit themeltar në mënyrë që të mund të siguroj rreziqet e sigurimit për të cilat është e licencuar në Republikën e Kosovës.

Adresa e zyrtare e regjistruar: Zyrrat qendrore të Shoqërisë gjenden në Rr. Komuna e Parisit, Pallatet Lura, Kati i dytë, Tiranë, Shqipëri. Adresa e degës është në Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Shoqëria kishte 317 punonjës më 31 dhjetor 2021 (2020: 305).

Bordi mbikqyrës dhe bordi drejtues gjatë vitit 2021 dhe deri në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare konsiston si më poshtë:

Bordi Mbikëqyrës	Pozicioni	Bordi Drejtues	Pozicioni
Z. Peter Hoefinger	Kryetar	Z. Klaidi Citozi	Drejtor i Përgjithshëm
Z. Christoph Rath	Zv. Kryetar	Z. Artan Pjeternikaj	Anëtar Bordi
Z. Jonard Prodani	Anëtar	Z. Ervin Rali	Anëtar Bordi
Zj. Liane Hirner	Anëtar		
Zj. Sonja Raus	Anëtar		

2. Bazat e kontabilitetit

Këto pasqyra financiare të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a. (referencuar më poshtë si "Shoqëria") janë përgatitur në përputhje me SNRF-të) siç është lëshuar nga Bordi i Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit (BSNK).

Monedha funksionale dhe e paraqitjes Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lekë Shqiptare (Lekë), të rrumbullakosura në mijë Lekë. Lekë është monedha funksionale e njësisë raportuese, monedha kryesore e mejdiseit ekonomik në të cilin njësia raportuese kryen veprimtarinë e saj. Monedha funksionale e operacioneve të saj të jashtme në Kosovë është Euro ("EUR") siç përshkruhet në shënimin 5.b..

Bazat e matjes. Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të pronave të investuara dhe ndërtesave të caktuara (të klasifikuara si prona dhe pajisje) të cilat maten me vlerën e drejtë.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveç nëse është shprehur ndryshe (shiko shënimin 3 për miratimin e standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara dhe deklaratave të reja kontabël të miratuara nga Shoqëria).

2. Bazat e matjes (vazhdim)

Përmbledhje e çmuarjeve dhe gjykimeve kontabël Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara kontabël. Gjithashtu kërkohet që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të Shoqërisë. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme që preket. Drejtimi beson se supozimet bazë janë të përshtatshme dhe se pasqyrat financiare si rrjedhojë paraqesin pozicionin financiar dhe rezultatet në mënyrë të drejtë. Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi ose kompleksiteti, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë të detajuara në shënimin 6.

Vijimësia. Drejtimi i Njesisë Raportuese ka vlerësuar aftësinë për të vazhduar në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burime për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Njësia Raportuese është e kapitalizuar mirë dhe ka marzhe të mira sigurie nga raportet minimale rregullatore. Drejtimi nuk është i vetëdijshëm për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Njesisë Raportuese për të vazhduar në vijimësi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e vazhdimësisë.

Krahasueshmëria. Riklasifikime të caktuara janë bërë me qëllim që të sigurohet një prezantim dhe shpalosje më e mirë në pasqyrat financiare më 31 dhjetor 2021 dhe më 31 dhjetor 2020. Më konkretisht:

- "Kapitali i themeluar i Degës në Kosovë" prej 422,400 mijë lekë është paraqitur nën "Fitimet e pashpërndara" në pasqyrën e pozicionit financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, dhe për të dyja periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 kjo është paraqitur në "Rezervat ligjore të sigurimeve". Në lidhje me këtë riklasifikim janë bërë shpalosjet përkatëse në shënimet e pasqyrave financiare.
- "Mjete monetare të kufizuara" prej 481 mijë lekësh është paraqitur si mjete monetare dhe ekuivalente monetare në pasqyrën e flukseve monetare dhe për të dyja periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020 kjo është paraqitur si aktivitet operativ. Në lidhje me këtë riklasifikim janë bërë shpalosjet përkatëse në shënimet e pasqyrave financiare.
- "Interesi i marrë" prej 126,914 mijë lekë është paraqitur në aktivitetin investues në pasqyrën e flukseve monetare dhe për të dyja periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2021 dhe 31 dhjetor 2020, kjo është paraqitur si aktivitet operativ.

3. Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese

Politikat kontabël të miratuara janë në përputhje me ato të vitit financiar të mëparshëm, me përjashtim të SNRF-ve të mëposhtme të ndryshuara në vijim, të cilat janë miratuar nga Shoqëria më 1 janar 2021:

- **Reforma e Referencës së Normës së Interesit – Faza 2 – SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16 (Ndryshime)**

Në gusht 2020, BSNK publikoi Reformën e Referencës së Normës së Interesit – Faza 2, Amendimet e SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16, duke përfunduar punën e saj në përgjigje të reformës IBOR. Amendimet parashikojnë lehtësime të përkohshme të cilat trajtojnë efektet e raportimit financiar kur norma e interesit ndërbankar (IBOR) që ofrohet zëvendësohet me një normë interesi alternative pothuajse pa rrezik (RFR). Në veçanti, amendimet parashikojnë një lehtësi praktike për kontabilizimin e ndryshimeve në bazën e përcaktimit të flukseve monetare kontraktuale të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare, për të kërkuar që norma efektive e interesit të rregullohet, e cila është ekuivalente me një lëvizje në një normë interesi të tregut. Gjithashtu, amendimet prezantojnë lehtësime nga ndërprerja e marrëdhënieve mbrojtëse, duke përfshirë një lehtësim të përkohshëm nga detyrimi për të përmbushur kërkesat që janë identifikuar veçmas në momentin kur një instrument RFR përcaktohet si një mjet mbrojtës për një element të rrezikut. Amendime janë bërë edhe tek SNRF 7 Instrumentet Financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese me qëllim për t'u ofruar përdoruesve të pasqyrave financiare mundësinë për të kuptuar efektin e reformës së referencës së normës së interesit në instrumentet financiare të një njësie ekonomike subjekti si dhe strategjinë e administrimit të riskut. Për shkak se zbatimi i standardit është retrospektiv, subjektet nuk janë të detyruara që të riparaqesin periudhat e mëparshme. Ndryshimet nuk kishin ndikim në pasqyrat financiare sepse Njësia Raportuese nuk ka investime me normë fleksibël që parashikohet të ndryshojë normën.

3. Ndryshime në politikat kontabël dhe shënimet shpjeguese (vazhdim)

- **SNRF 4: Kontratat e Sigurimit (Ndryshimet)**

Ndryshimet në SNRF 4 ndryshojnë datën fikse të skadencës për përjashtimin e përkohshëm në SNRF 4 Kontratat e Sigurimit nga zbatimi i SNRF 9 Instrumentet Financiare, në mënyrë që njësitë ekonomike do t'u kërkohej të zbatojnë SNRF 9 për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2023. Njësia Raportuese ka një projekt në vazhdim dhe po vlerëson ndikimin.

4. Standarde dhe interpretime të reja

Janë publikuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021 ose më vonë, dhe të cilat Shoqëria nuk i ka adoptuar herët.

- **SNRF 17: Kontratat e Sigurimit**

Standardi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2021 me aplikim më të hershëm të lejuar nëse janë zbatuar edhe SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët dhe SNRF 9 Instrumentet Financiare. Në mbledhjen e tij të marsit 2020, Bordi vendosi të shtyjë datën e hyrjes në fuqi në vitin 2023. SNRF 17 Kontratat e Sigurimit përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të kontratave të sigurimit të lëshuara. Ai gjithashtu kërkon që parime të ngjashme të zbatohen për kontratat e risigurimit të mbajtura dhe kontratat e investimit me karakteristika të pjesëmarrjes diskrecionale të lëshuara. Objektivi është të sigurohet që njësitë ekonomike të ofrojnë informacionin përkatës në një mënyrë që përfaqëson me besnikëri ato kontrata. Ky informacion u jep një bazë përdoruesve të pasqyrave financiare për të vlerësuar efektin që kanë kontratat brenda objektit të SNRF 17 në pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset monetare të një njësie ekonomike. Projekti SNRF 17 po organizohet dhe zbatohet në nivel grupi. Njësia Raportuese po rivlerëson modelet e saj në mënyrë që të jetë gati dhe në përputhje me kërkesat e reja. Një studim paraprak i kërkesave teknike dhe thelbësore të SNRF 17 u krye përpara fillimit të projektit SNRF 17 në të gjithë Shoqërinë Raportuese. Pas analizimit të rezultateve të studimit paraprak, u krijua një strukturë projekti në të gjithë Shoqërinë Raportuese. Standardi SNRF 17 është trajtuar në mënyrë specifike në një sërë grupesh pune metodologjike që nga fillimi i programit. Projekti i Shoqërisë Raportuese po fokusohet gjithashtu në rishikimin e modelit aktuarial dhe zbatimin e një nënlibri llogarish për nënshkrimet. Për shkak të pasigurive ekzistuese, aktualisht nuk është e mundur të përcaktohet sasia e efektit në pasqyrat individuale të pozicionit financiar dhe zërat e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Megjithatë, Shoqëria Raportuese pret që standardi i ri do të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e saj financiare.

- **SNRF 17: Kontratat e sigurimit – Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 – Informacion Krahasues (Ndryshime)**

Ndryshimi është efektiv për periudhat e raportimit vjetor që fillojnë në ose pas 1 janarit 2023, me zbatimin e hershëm të lejuar përkatësisht me SNRF 17. Për njësitë ekonomike që zbatojnë fillimisht SNRF 17 dhe SNRF 9 në të njëjtën kohë, ndryshimi shton një opsion kalimi për një "mbivendosje klasifikimi", në lidhje me informacionin krahasues të aktiveve financiare. Një njësi ekonomike që aplikon mbivendosjen e klasifikimit për një aktiv financiar duhet të paraqesë informacion krahasues sikur kërkesat e klasifikimit dhe matjes të SNRF 9 të ishin zbatuar për atë aktiv financiar. Gjithashtu, në zbatimin e mbivendosjes së klasifikimit për një aktiv financiar, një njësi ekonomike nuk i kërkohej të zbatojë kërkesat e zhvlerësimit të SNRF 9. Ndryshimi synon të ndihmojë njësitë ekonomike të shmangin mospërputhjet e përkohshme kontabël midis aktiveve financiare dhe detyrimeve të kontratës së sigurimit, dhe për rrjedhojë të përmirësojnë dobinë e informacionit krahasues për përdoruesit e pasqyrave financiare. Këto ndryshime nuk janë miratuar ende nga BE. Drejtimi ka një projekt në vazhdim dhe pret ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e tij financiare.

4. Standarde dhe interpretime të reja (vazhdim)

- **Ndryshim në SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrje të Përbashkëta: Shitja ose Kontributi i Aktiveve ndërmjet një Investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët**

Ndryshimet trajtojnë një mospërputhje të pranuar midis kërkesave në SNRF 10 dhe atyre në SNK 28, në trajtimin e shitjes ose kontributit të aktiveve ndërmjet një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët. Pasoja kryesore e ndryshimeve është se një fitim ose humbje e plotë njihet kur një transaksion përfshin një biznes (nëse ai është i vendosur në një filial ose jo). Një fitim ose humbje e pjeshme njihet kur një transaksion përfshin aktive që nuk përbëjnë një biznes, edhe nëse këto aktive janë të vendosura në një filial. Në dhjetor 2015, BSNK shtyu datën e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi për një kohë të pacaktuar në pritje të rezultetit të projektit të saj kërkimor mbi metodën e kapitalit neto të kontabilitetit. Njësisia Raportuese ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në Pasqyrat e saj Financiare.

- **SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare: Klasifikimi i Detyrimeve si Aktuale ose Jorrijdhëse (Ndryshime)**

Ndryshimet fillimisht ishin efektive për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2022 me aplikimin e mëhershëm të lejuar. Megjithatë, në përgjigje të pandemisë Covid-19, Bordi e ka shtyrë datën e hyrjes në fuqi me një vit, pra 1 janar 2023, për t'u dhënë Shoqërive më shumë kohë për të zbatuar çdo ndryshim klasifikimi që rezulton nga ndryshimet. Ndryshimet synojnë të nxisin konsistencën në zbatimin e kërkesave duke ndihmuar Shoqëritë të përcaktojnë nëse, në pasqyrën e pozicionit financiar, borxhi dhe detyrimet e tjera me një datë të pasigurt shlyerjeje duhet të klasifikohen si rrjedhëse ose afatgjata. Ndryshimet ndikojnë në paraqitjen e detyrimeve në pasqyrën e pozicionit financiar dhe nuk ndryshojnë kërkesat ekzistuese rreth matjes ose kohës së njohjes së ndonjë aktivi, pasivi, të ardhurash ose shpenzimi, as informacionin që njësitë japin informacione për këta zëra. Gjithashtu, ndryshimet sqarojnë kërkesat e klasifikimit për borxhin që mund të shlyhet nga shoqëria që emeton instrumente të kapitalit të vet.

Në nëntor 2021, Bordi lëshoi një draft ekspozimi (DE), i cili sqaron se si të trajtohen detyrimet që janë subjekt i marrëveshjeve për t'u zbatuar, në një datë pas periudhës raportuese. Në veçanti, Bordi propozon ndryshime me shtrirje të ngushtë në SNK 1, të cilat në mënyrë efektive i kthejnë ndryshimet e vitit 2020, duke kërkuar që njësitë ekonomike të klasifikojnë si rrjedhëse, detyrimet që i nënshtrohen marrëveshjeve, të cilat duhet të përmbushen vetëm brenda dymbëdhjetë muajve të ardhshëm pas periudhës së raportimit, nëse ato marrëveshje nuk janë u takua në fund të periudhës raportuese. Në vend të kësaj, propozimet do të kërkonin që njësitë ekonomike të paraqesin veçmas të gjitha detyrimet afatgjata që i nënshtrohen marrëveshjeve për t'u përmbushur vetëm brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës së raportimit. Për më tepër, nëse njësitë ekonomike nuk respektojnë këto marrëveshje të ardhshme në fund të periudhës raportuese, do të kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese shtesë. Propozimet do të hyjnë në fuqi për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2024 dhe do të duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8, ndërkohë që lejohet miratimi i hershëm. Bordi ka propozuar gjithashtu që të shtyhet data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve të vitit 2020 në përputhje me rrethanat, në mënyrë që subjekteve të mos u kërkojë të ndryshojnë praktikën aktuale përpara se ndryshimet e propozuara të hyjnë në fuqi. Shoqëria Raportuese ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale, objektet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivët Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet)**

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2022 me aplikim të mëhershëm të lejuar. BSNK ka nxjerrë ndryshime me qëllim të ngushtë në Standardet SNRF si më poshtë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit (Ndryshimet)** përditësojnë një referencë në SNRF 3 për Kuadrin Konceptual për Raportimin Financiar pa ndryshuar kërkesat e kontabilitetit për kombinimet e biznesit.
- **SNK 16 Aktivët afatgjata materiale (Ndryshimet)** e ndalon një Shoqëri të zbresë nga kostoja e aktiveve afatgjata materiale shumtë e marra nga shitja e artikujve të prodhuar ndërkohë që Shoqëria po përgatit aktivin për përdorimin e synuar. Në vend të kësaj, një Shoqëri do të njohë të ardhurat e tilla nga shitjet dhe kostot përkatëse në fitim ose humbje.
- **SNK 37 Provizionet, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivët e Kushtëzuara (Ndryshimet)** specifikojnë se cilat kosto përfshin një shoqëri në përcaktimin e kostos së përmbushjes së një kontrate me qëllim të vlerësimit nëse një kontratë është rënduese.

4. Standarde dhe interpretime të reja (vazhdim)

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit; SNK 16 Aktivët afatgjata materiale, objektet dhe pajisjet; SNK 37 Provizionet, Detyrimet dhe Aktivët Kontingjente si dhe Përmirësimet Vjetore 2018-2020 (Ndryshimet) (vazhdim)**

- **Përmirësimet vjetore 2018-2020** bëjnë ndryshime të vogla në SNRF 1 Miratimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNK 41 Bujqësia dhe shembujt ilustrues që shoqërojnë SNRF 16 Qiratë

Njësia Raportuese ka vlerësuar se ndryshimi nuk do të ketë ndikim në pasqyrat e saj financiare.

- **SNRF 16 Qiratë-Covid 19 Koncesionet e Qirasë të Lidhura (Ndryshim)** - Ndryshimi zbatohet për periudhat vjetore të raportimit që fillojnë më ose pas datës 1 Prill 2021, me aplikim të mëhershëm të lejuar, duke përfshirë në pasqyrat financiare të paautorizuara ende për publikim në datën e lëshimit të amendamentit. Në mars 2021, Bordi ndryshoi kushtet e dobisë praktike në SNRF 16 që ofron lehtësim për qiramarrësit nga zbatimi i udhëzimit të SNRF 16 mbi modifikimet e qirasë për koncesionet e qirasë që lindin si pasojë e drejtpërdrejtë e pandemisë Covid-19. Pas ndryshimit, dobia praktike tani zbatohet për koncesionet e qirasë për të cilat çdo reduktim në pagesat e qirasë prek vetëm pagesat që duhet të paguhen fillimisht në ose para datës 30 qershor 2022, me kusht që të plotësohen kushtet e tjera për aplikimin e dobisë praktike.

Ndryshimi nuk kishte ndikim në pasqyrat financiare të Njesisë Raportuese pasi ajo nuk kishte ndonjë ndryshim të afatit të qirasë lidhur me Covid-in.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Njësia Raportuese, përveç nëse është shprehur ndryshe.

(a) Investimet e përbashkëta dhe kontabilizimi për degët e njësisë raportueses në vendet e tjera.

Investimet në filiale, pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta maten me kosto minus humbjen nga zhvlerësimi. Kostot e transaksionit kapitalizohen si pjesë e koston së investimit. Kostot e transaksionit janë kostot që i atribuohen drejtpërsëdrejti blerjes së investimit, një tarifë e tillë e profesionit për shërbimet ligjore, taksat e transferimit dhe kostot e tjera të blerjes. Kostoja fillestare e investimeve përfshin gjithashtu edhe shumën e kushtëzuar. Rivlerësimi i mëposhtëm i shumës së kushtëzuar të klasifikuar si pasiv financiar rregullohet kundrejt kostove të investimit. Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera kontabël e një investimi mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë e vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlera e tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, atëherë vlera kontabël zvogëlohet në shumën e rikuperueshme. Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet nga nxjerrja jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit të shitjes dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta vlen edhe nëse rezultati i nxjerrë jashtë përdorimit rezulton në një hap më poshtë nga filiali tek sipërmarrja e përbashkët ose një pjesëmarrja, matet me kosto.

Marrëveshje të përbashkëta. Sipas SNRF 11, investimet në marrëveshjet e përbashkëta klasifikohen si operacione të përbashkëta ose sipërmarrje të përbashkëta, në varësi të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të secilit investitor. Njësia raportuese ka vlerësuar natyrën e marrëveshjes së saj të përbashkët me Intersig Vienna Insurance Group SH.A. në VIG Services sh.p.k. dhe i përcaktoi ato si sipërmarrje të përbashkëta. Sipërmarrjet e përbashkëta maten me kosto minus humbjen nga zhvlerësimi. Shoqëria ka përdorur përjashtimin sipas SNK 28.

Shitja e filialeve, pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta. Kur njësia raportuese pushon të ketë kontroll ose ndikim të rëndësishëm, çdo interes i ruajtur në njësinë ekonomike rimerret në vlerën e tij të drejtë në datën kur humbet kontrolli, me ndryshimin në vlerën kontabël neto të njohur në fitim ose humbje. Vlera e drejtë është vlera kontabël fillestare për qëllime të kontabilizimit të mëvonshëm të interesit të mbajtur si një pjesëmarrje, sipërmarrje e përbashkët ose aktiv financiar. Përveç kësaj, çdo shumë e njohur më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në lidhje me atë njësi ekonomike, llogaritet sikur njësia raportuese të kishte drejtpërdrejt në dispozicion aktivet ose detyrimet përkatëse. Kjo mund të thotë që shumat e njohura më parë në të ardhura të tjera përmbledhëse janë riklasifikuar në fitim ose humbje. Nëse interesi i pronësisë në një pjesëmarrje zvogëlohet, por ndiqet një ndikim i rëndësishëm, vetëm një pjesë proporcionale e shumave të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen në fitim ose humbje kur është e përshtatshme.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Filialet që veprojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Njësia raportuese vepron në Kosovë përmes filialeve të saj, të cilat janë regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës. Njësia raportuese raporton aktivitetet e filialeve të saj të huaj në pasqyrat financiare të konsoliduara si pjesë përbërëse e subjektit raportues duke grupuar të gjitha bilancet dhe transaksionet e saj sikur të ishte një njësi e vetme ekonomike.

(b) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetare të cilat janë njohur me kosto historike konvertohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Rezultatet dhe pozicioni financiar i operacioneve të huaja përkthehen në monedhën e prezantimit të këtyre pasqyrave financiare si më poshtë:

- i. aktivitetet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të pozicionit financiar janë përkthyer me normën e mbylljes në fund të periudhës përkatëse raportuese;
- ii. të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin mesatar të këmbimit (përveç rastit kur kjo mesatare nuk është një përafrim i arsyeshëm i efektit kumulativ të normave që mbizotërojnë në datat e transaksionit, në të cilin rast të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen në datat e transaksioneve);
- iii. të gjitha diferencat e këmbimit që rezultojnë njihen në të ardhura të tjera përmbledhëse dhe akumulohen në rezervën e përkthimit në kapital dhe;
- iv. Rezerva e kapitalit të autorizuar të Degës së Kosovës përkthehet me kurs historik.
- v. flukset monetare përkthehen gjithashtu në monedhën e prezantimit duke përdorur kursin mesatar të këmbimit për periudhën.

(c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Produktet e sigurimit të njësisë raportuese klasifikohen në momentin e krijimit, për arsye kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi mbetet e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet shuhën ose pushojnë së ekzistuari.

Kontratat nën të cilat njësia raportuese pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguroese) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar.

Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të ardhshme të mundshme në një ose më shumë norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, çmimet e komoditeteve, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, vlerësimi i aftësisë kredituese, indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

Kontratat e përgjithshme të sigurimit. Detyrimet e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e angazhimeve të ardhshme (të pafituara), rreziku i angazhimeve të ardhshme (të pambaruara) dhe humbjet e angazhimeve të ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Njësia raportuese nuk i skonton detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet me pasiguritë dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të informuara. Njësia raportuese ka përdorur kërkesat e legjislacionit shqiptar të sigurimeve për të përcaktuar detyrimet e sigurimit.

Prime të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit. Primet e shkruara bruto përbëjnë shumat e detyruara gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma mund ti përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhe kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe nuk përfshijnë tatimet dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

5. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit (vazhdim)

Rezerva për primin e pafituar. Rezerva e primit të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila vlerësohet të fitohet në vitin financiar pasardhës, duke përdorur metodën ditore në bazë proporcionale 1/365, e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Megjithatë, të gjitha produktet e njësisë raportuese kanë rrezik linear dhe asnjë rregullim për ndryshime të rrezikut nuk është bërë. Primi i pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e nënshkruara të cilat prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatimet dhe detyrimet doganore të bazuara tek primet. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim njihen më vete si aktive.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë pjesa e kostove të marrjes në sigurim të cilat zbriten gjatë llogaritjes së rezervës së primit të pafituar. Komisionet dhe shpenzimet e tjera (për shembull, pagat e punonjësve të caktuar të përfshirë në nënshkrimin dhe funksionet e lëshimit të politikave, dhe tarifrat mjekësore dhe të inspeksionit) që lidhen kryesisht me kontratat e sigurimit të lëshuara ose të rinovuara gjatë periudhës në të cilën janë kryer shpenzimet, konsiderohen kosto të blerjes.

Shpenzimet e blerjes kapitalizohen dhe ngarkohen në shpenzim në proporcion me të ardhurat e primit të njohura. Për të lidhur kostot e blerjes me të ardhurat përkatëse të primit, kostot e blerjes ndahen nga grupime sipas kontratave të sigurimit në përputhje me mënyrën e blerjes, shërbimit dhe matjes së rentabilitetit të kontratave të sigurimit të njësisë raportuese. Kostot e blerjes të paamortizuara klasifikohen si një aktiv.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit Dëmet e ndodhura përbëhen nga shuma e shlyerjes dhe kostot e trajtimit të dëmeve të paguara ose të papaguara të lindura nga ngjarje të ndodhura në vitin financiar, së bashku me rregullime në provigjionet e dëmeve të viteve të mëparshme. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe duke provigjionuar dëmet e ndodhura por ende të paraportuara, efekti i ngjarjeve të parashikuara të brendëshme dhe të jashtëme, të tilla si ndryshimet e procedurave në trajtimin e dëmeve, inflacioni, tendencat juridike, ndryshimet legjislative dhe eksperiencat e mëparëshme. Provizioni për dëmet e papaguara nuk skontohej.

Rregullimet për provizionin e dëmeve të viteve të mëparëshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale.

Provizionet për pretendimet e ndodhura por të pa raportuara vlerësohen bazuar në metodën e trekëndëshave për produktet e përgjegjësive së palës së tretë motorike ("MTPL") dhe Kartonit Jeshil duke filluar nga viti 2008, ndërsa për sigurimin e Pronës, Shëndetit, Aksidenteve Personale & Udhëtimeve për llogaritja IBNR është përdorur e njëjta metodologji mbi të dhënat historike të dëmeve të shkaktuara/të paguara për periudhën 2008-2021, 2015-2021, 2013-2021, përkatësisht

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit (vazhdim) Përveç kësaj, IBNR për humbjet e mëdha të Pronës krijohet bazuar në numrin e vlerësuar të pretendimeve të mëdha dhe shumës së pretendimeve për humbje të mëdha të përcaktuara në Manualin e Brendshëm për Procedurat Aktuariale (250.000 EUR).

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve Shoqëria bën një test të mjaftueshmërisë të detyrimit për të siguruar mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve dhe rezervës së primit të pafituar. Përmbajtja vjetore përdoret për provizionet e dëmeve. Realizimi i kësaj analize përdoret për të kontrolluar mjaftueshmërinë dhe metodologjinë e RBNS dhe IBNR të kryera veçmas për një vit të caktuar. Në rast se analiza tregon mospërputhje të mëdha (rezultat negativ), bëhen rregullimet e duhura në metodologjinë e rezervimit.

Një test shtesë i mjaftueshmërisë së detyrimit kryhet për UPR që përfaqëson llogaritjen e rezervës së rrezikut të pa skaduar (URR). Kjo rezervë llogaritet në bazë tremujore nga Njësia Raportuese. Variabla kryesore e përdorur është raporti i kombinuar (shuma e kërkesës dhe raporti i shpenzimeve). Nëse vlera e raportit të kombinuar është nën 100%, UPR mund të konsiderohet si e përshtatshme. Në rast se raporti i kombinuar është më i madh se 100%, atëherë URR do të formohet dhe rezervohet për të plotësuar mungesën e UPR.

